



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/0988**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) LevelMax L.L.C. kundër Vendimit të AK - Akademia e Kosoves per Siguri Publike në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi I objekteve ne AKSP me numër te prokurimit:214-25-4240-5-2-1, me 12/11/2025, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE LevelMax L.L.C. me nr. 2025/0988, e datës 06/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi I objekteve ne AKSP me numër të prokurimit: 214-25-4240-5-2-1.
2. Anulohet njoftimi për dhënie të kontratës, ndërkaq aktiviteti i prokurimit “Renovimi I objekteve ne AKSP” me numër të prokurimit: 214-25-4240-5-2-1 kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik LevelMax L.L.C.

### **Arsyetim**

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30/05/2025, Akademia e Kosoves per Siguri Publike në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Renovimi I objekteve ne AKSP me numër të prokurimit: 214-25-4240-5-2-1.

Ndërsa me datën 19/09/2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer Operatorin Ekonomik N.N.P Wenda & Muhamet Muçiqi B.I. & Ibrahim Kurrumelli B.I. ne çmim total te ofertës 95,866.34 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 100,000.00 €

Me 24/09/2025, OE LevelMax L.L.C.ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06/10/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE LevelMax L.L.C. me nr. 0988/2025 lidhur me aktivitetin “Renovimi I objekteve ne AKSP” me numër të prokurimit:214-25-4240-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues LevelMax L.L.C. janë parashtruar si në vijim:

Lidhur me aktivitetin e prokurimi nga Autoriteti Kontraktues: AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE me titull: Renovimi i objekteve në AKSP numër te 214-25-4240-5-2-1 nr.brendeshem 214-25- 12-5-2-1

Me poshte po i sjellim kunder argumentet nga vendimi i AK-se lidhur me kerkesen per rishqyrtim ne AK te dates:25.09.2025

Sa i përket përgjigjes së Autoritetit Kontraktues, vlerësojmë se ajo është e pabazuar në fakte dhe argumente. Në lidhje me pretendimin për pozitën Teknik i ndërtimtarisë, theksojmë se për punëtorin z. Endrit Ramadani kemi ofruar diplomën e tij, e cila është dëshmi kryesore që vërteton se ai është Teknik i ndërtimtarisë dhe plotëson kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu, z. Endrit Ramadani është edhe Bachelor i Arkitekturës, me ç’rast janë lëshuar edhe certifikatat përkatëse, të cilat në këtë rast nuk janë të domosdoshme, pasi kushti themelor është për Teknik të ndërtimtarisë — kriter të cilin ai e plotëson plotësisht

Lidhur me njoftimin e bërë nga zyrtari i prokurimit, vlerësojmë se konstatimet e paraqitura në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim nuk qëndrojnë dhe nuk janë të vërteta. Sipas mendimit tonë, ato janë të pabazuara dhe tendencioze. Oferta jonë është serioze dhe plotësisht në përputhje me standardet e ndërtimtarisë. Sa i përket krahasimit të çmimit me projektin e renovimit të realizuar vitin e kaluar, theksojmë se projekti aktual përfshin rreth gjysmën e punimeve krahasuar me atë të mëparshmin, megjithatë ka të njëjtën vlerë të parashikuar financiare. Kjo tregon se projekti i kaluar ka pasur punë dyfish më shumë se projekti i këtij viti. Po ashtu, sa i përket pretendimit se menaxheri nuk ka lëshuar referencë për shkak të mos[1]përmbajtjes së

garancionit, theksojmë se kjo nuk është e vërtetë. Në adresën tonë nuk ka arritur asnjë kërkesë zyrtare për të cilën nuk jemi përgjegjgur. Ne gjithmonë kemi bashkëpunuar dhe jemi përgjegjgur në mënyrë korrekte e brenda afateve për çdo kërkesë të institucioneve përkatëse.

Në vijim, po i paraqesim faktet dhe argumentet tona kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues (AK), me qëllim të sqarimit të plotë të rrethanave dhe të vërtetimit se oferta jonë është e rregullt dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Lidhur me këtë aktivitet, AK: Akademia e Kosovës për Siguri Publike si fillim ka marrë vendim që ta shpërblejë me kontratë OE me të lirë DUO Construction sh.p.k., dhe OE të tjera pasuese janë të përgjegjshme, përveç njëres që ka qenë e papërgjegjshme, pra kompania jonë në vendimin e parë ka qenë e përgjegjshme.

Pas kërkesave për rishqyrtim nga operatorët, kjo lëndë është kthyer në rishqyrtim dhe AK me datë 19.09.2025 merr vendim dhe e shpërblen me kontratë OE në renditje të çmimit, në procesverbal me numër 4, që është OE Wenda me çmim prej 95,866.34 euro. Kompaninë tonë e ka shpallur të papërgjegjshme për këto pretendime që i konsiderojmë të padrejta:

Siç shihet më lart, pretendimi i AK-së se punëtori Qemajl Ramadani nuk e përmbush kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit nuk qëndron, dhe ky punëtor i përmbush të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Më poshtë po i sjellim faktet për këtë pretendim.

Si fillim po citojmë kërkesën në dosjen e tenderit: “Një teknik të ndërtimtarisë i diplomuar nga shkolla e mesme ose profesionale” dhe ne për këtë kërkesë kemi sjellë teknikun Qemajl Ramadani me diplomë nga shkolla profesionale.

Diploma është e lëshuar nga shkolla teknike “Jeta e Re” në Suharekë, që është edhe sot shkollë profesionale. Punëtori është i diplomuar në degën e ndërtimtarisë, që nënkupton se është teknik i ndërtimtarisë, por është në profesionin e ndarë që është Murator-Fasader. Kjo nuk është ndonjë devijim i madh, pasi koha e diplomimit është shumë herët, dmth 1987, dhe ky punëtor e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Po ashtu, AK është dashur të kërkojë sqarime shtesë sipas ligjit të LPP-së, pasi në listën e anëtarit të konsorciumit Harst Group sh.p.k. gjendet lista prej 18 punëtorëve, ku aty gjendet edhe një teknik i ndërtimtarisë me emrin Endrit Ramadani, që është punëtor i përhershëm i kompanisë me kontratë të rregullt sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. Do t’ju bashkëngjesim dokumentet e nevojshme në folder. Më poshtë e gjeni listën e punëtorëve të Harst Group sh.p.k.

Ne kemi ofruar punëtorin Liman Murseli – Hidroizolues, i cili posedon certifikatën përkatëse dhe i plotëson kushtet e dosjes së tenderit. Pra, për këtë pozitë të kërkuar (një hidroizolues), ne kemi ofruar punëtorin e kualifikuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Kërkesa nga dosja e tenderit është: Tre shtrues të pllakave. Ne kemi ofruar katër shtrues të pllakave, ndërkohë që kërkesa ka qenë vetëm për tre. Pra, ne jo vetëm që e plotësojmë, por e tejkalojmë kërkesën e dosjes së tenderit.

Lidhure me këtë pretendimi , për dy punëtorët Metë Bytyqi dhe Perparim Selimaj, se u mungon certifikata, nuk qëndron. AK është e detyruar nga neni 72 i LPP-së që të kërkojë sqarime shpesh dhe ju sqarojmë se këta dy punëtorë që janë në listën tonë nuk janë të nevojshëm në kërkesën e dosjes së tenderit, pasi ne kemi ofruar punëtorët e nevojshëm me certifikata sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Edhe nga AK nuk është cituar se cilët punëtorë mungojnë.

Pretendimi tjetër është se punëtori Agron Zejnaj nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit. Kjo nuk qëndron, pasi është punëtor i certifikuar për murator dhe fasader, gjë që nuk është në kundërshtim me asnjë normë ligjore. Certifikata është lëshuar nga organet kompetente, të cilat ne nuk jemi kompetent t'i vlerësojmë. Pra, Agron Zejnaj e plotëson kushtin si punëtor me titull Murator, që është edhe kërkesë e dosjes.

Pretendimi tjetër për kompaninë DUO Construction sh.p.k., që është me çmim më të lirë se kompania jonë, qëndron se kjo kompani nuk i ka plotësuar kushtet e dosjes së tenderit. Njëra ndër to është marrëveshja e konsorciumit, që nuk e ka plotësuar sipas udhëzimit të KRPP-së, dhe kjo kompani është e papërgjegjshme. AK ka bërë shkelje të nenit 1 të LPP-së duke shpallur fitues një kompani që ka një çmim shumë më të lartë se ne. Pra, kjo diferencë është 16,466.90 euro, që ndikon direkt në dëmtimin e buxhetit të shtetit. Lidhur me njoftimin e bërë nga zyrtari i prokurimit, vlerësojmë se konstatimet e paraqitura në vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim nuk qëndrojnë dhe nuk janë të vërteta. Sipas mendimit tonë, ato janë të pabazuara dhe tendencioze.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09/10/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0988/2025, ndërsa me datë 20/10/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0988/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE LevelMax L.L.C. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0988 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues Akademia e Kosovës për Siguri Publike, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës punë. Vlera e parashikuar e kontratës është 100,000.00€. Ndërsa, kriteri i dhënies së kontratës është tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët.

Sqarim hyrës: Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, sqarojmë se operatori ekonomik ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 69 dhe 72 të LPP-së.

Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, konkretisht kundër eliminimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues. Pretendimet e ngritura ankimore nga ana e operatorit ekonomik ankues janë shqyrtuar nga ekspertja duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe jep përgjigje si në vijim.

Pretendimi ankimor 1: OE ankues në ankesën e parashtruar në OSHP pretendon se është i përgjegjshëm dhe nuk qëndron vlerësimi i AK-së. Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK e ka eliminuar OE ankues me arsyetimin se OE ankues “LevelMax L.L.C. Harst Group Sh.p.k.” është i papërgjegjshëm për shkak se punëtori me numër rendor 3, Qendrim Ramadani nuk e plotëson kriterin e dosjes së tenderit si teknik i ndërtimtarisë, nga shkolla e mesme ose profesionale pasi në certifikatë i shkruan murator – fasader. Po ashtu, punëtorëve Metë Bytyqi, Përparim Selimaj ju mngon certifikata, ndërsa Agron Zejnan me certifikatë fasader.

OE ankues i pa kënaqur me vendimin e AK-së, parashtron kërkesë për ri shqyrtim duke pretenduar se Qemajl Ramadani i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit sepse në dosje është kërkuar *“një teknik i ndërtimtarisë i diplomuar nga shkolla e mesme ose profesionale”* dhe për këtë kërkesë ka sjellë teknikun Qemajl Ramadani me diplomë nga shkolla profesionale, duke i bashkangjitur diplomën e lëshuar nga shkolla teknike “Jeta e Re” në Suharekë. Kurse, si arsyetim jep se *“punëtori është i diplomuar në degën e ndërtimtarisë, që nënkupton se është teknik i ndërtimtarisë, por në profesionin e ndarë që është “Murator-fasader”, kjo nuk është një devijim i madh, pasi koha e diplomimit është shumë herët, d.m.th. 1987, dhe ky punëtor e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.”*

Përgjigje në pretendimin ankimor 1: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të pretendimit ankimor sqaron se AK në dosje të tenderit ka kërkuar:

#### *9.1&9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional:*

*“2. Lista e punëtorëve prej minimum 16 punëtorëve që drejtpërdrejtë janë përgjegjës për kryerjen e punëve përkatëse për këtë projekt me profesione si në vijim -Një saldues, -Një teknik të ndërtimtarisë i diplomuar nga shkolla e mesme ose profesionale, -Dy teknik instalues të elektrikes, -Një latues, -Dy moler , -Një suvatures, -Një murator, -Një hidroizolues , - Një hidroinstalues, -Tre shtrues të pllakave, -Dy instalues të ngrohjes qendrore”*

Për këtë kërkesë, dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar:

*1. Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga O.E. dhe dëshmitë sipas kerkeseave për inxhinierin si ne vijim Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, diploma e fakultetit - kopje. O.E. duhet të dëshmoj listen e puntoreve te kompanisë me te dhenat emrin,mbiemrin dhe profesioni në kompani e nënshkruar dhe vulosur.( ndërsa për puntoret qertifikatat e trajnimeve ). •Vendimi me shkrim mbi caktimin e*

*menaxherit inxhier i ndërtimaris konstruktive për këtë projektin në fjalë i nënshkruar dhe i vulosur nga OE. Lista e mjeteve apo paisjeve teknike që janë në dispozicion tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë paisjet dhe makineria në dispozicion duhet të deshmoen me kopje të librezave mbi pronsin e tyre ose DUDi doganor, ose fatura të blerjes ose kontrata mbi qiranë të dorëzohet një kopje të qarte dhe të lexueshme e nënshkruar dhe vulosur.*

Pra, nga kërkesa më lart, shihet se AK në mesin e punëtorëve ka kërkuar një “teknik të ndërtimtarisë” i diplomuar nga shkolla e mesme ose profesionale, kurse OE ankues për punëtorin Qmajl Ramadani ka dorëzuar diplomën e lëshuar nga shkolla teknike “Jeta e Re” në Suharekë, ku në këtë diplomë saktësohet se Qemajl Ramadani në “Jeta e Re” fitoi shkallën “III/ E TRETË” të përgatitjes profesionale të degës “ndërtimtarisë” të profesionit “Murator-Fasader”. Pra, pretendimi i OE ankues është i pa bazuar sepse shumë qartë precizohet në diplomë që profesioni i personit në fjalë është “murator-fasader”.

Pretendimi ankimor 2. Më tej, OE ankues pretendon se AK është dashur të kërkoj sqarime sipas LPP-së, pasi që në listën e anëtarit të konsorciumit “Harst Group” Sh.p.k. gjendet lista prej 18 punëtorëve dhe aty gjendet edhe një teknik i ndërtimtarisë me emrin Endrit Ramadani që është punëtor i përhershëm i kompanisë me kontratë të rregullt. Tutje, OE ankues thekson se për punëtorin z. Endrit Ramadani kemi ofruar diplomën e tij, e cila është dëshmi kryesore që vërteton se ai është Teknik i ndërtimtarisë dhe plotëson kriterin e kërkuar në dosjen e tenderit. Gjithashtu, z. Endrit Ramadani është edhe Bachelor i Arkitekturës, me ç’rast janë lëshuar edhe certifikatat përkatëse.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të diplomës së Endrit Ramadani, sqaron se i njëjti ka “Diplomë” për kryerjen e shkollës së mesme të lartë profesionale, lëshuar nga shkolla “Skënder Luarasi” në Suharekë, me nr. Prot.8/2077, nr. Vendimi 2730211/1, drejtimi “Ndërtimtari” dhe profili “Ndërtimtari”. Ekspertja vlerëson se ky person e plotëson kërkesën e AK-së “teknik të ndërtimtaris i diplomuar nga shkolla e mesme ose profesionale”. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues në vijim të ankesës pretendon se AK në kërkesën për ri shqyrtim ka cekur se OE ankues ka vendosur çmime të cilat nuk kanë të bëjnë më çmimet e tregut, d.m.th. çmime jo normalisht të ulëta pasi që në DNV janë paraparë 100,000.00 euro për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa OE ankues ka ofertuar me çmim prej 79,399.44 euro. AK po ashtu ka cekur disa pozicione, konkretisht “punimet e hidroizolimit dhe qeramikës”, te pika 2.1 – m2 – 1.5 euro, pozicioni 2.2 me çmim 1 euro për m2, pozicioni 2.3 me çmim 5 euro për m2, pozicioni 2.3 me çmim 5 euro për m2, pozicioni 2.4 me çmim 2.5 euro për m2, pozicioni 2.5 me çmim 25 euro për m2, pozicioni 2.6 me çmim 28 euro për m2. Pastaj, te “4. Punimet e suvatimit dhe plafonit”, te pika 4.1 me çmim prej 3 euro për m2. Në vijim të arsytimit të AK-së, theksohet se në vitin 2024, ju si OE keni pasur kontratë me AKSP për renovimet e objekteve të cilat janë bërë në AKSP, ku menaxheri i kontratës nuk ka rekomanduar të lëshojmë referencën për ju sepse nuk ju keni përmbajtur garancionit sipas kushteve të kontratës.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, konsideron se nuk mjafton që si arsytim të jepet “mos përmbushja e kushteve të kontratës” pa u mbështetur në prova shkresore. Pra, në rast të mos përmbushjes së kushteve të kontratës nga

operatorët ekonomik të caktuar, AK ka për obligim që të ndjek rruget ligjore kundrejt operatorëve ekonomik të cilët nuk i përmbushin kushtet e kontratës. Kurse sa i përket çmimeve, ku AK ka cekur çmimet jo normalisht të ulëta për pozicionet e lartcekura, mirëpo nuk ka ndjek rregullat e parapara ligjore sipas nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik. Neni 41 i kësaj Rregulloreje e ndalon përjashtimin automatik, pa përdorur një procedurë “inter partes” me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit, i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi ankimor 4: OE ankues pretendon se për punëtorin Agron Zejnaj AK e ka eliminuar me arsyetimin se të njëjtit i mungon certifikata.

Përgjigje në pretendimin ankimor 4: Ekspertja shqyrtuese pas shqyrtimit të ofertës së OE ankues, konkretisht follderit me titull “7.stafi 1”, nën follderin “6. Murator”, gjendet diploma sipas kërkesës së AK-së. Kjo diplomë është lëshuar nga shkolla e mesme teknike “Tafil Kasumaj” në Deçan, në emër të Agron Zejnaj, në të cilën shkruan “Murator – Fasader”. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar.

Pretendimi ankimor 5: Sa i përket pikës tjetër ankimore për punëtorët Metë Bytyqi dhe Përparim Selimaj, ku OE ankues pretendon se AK konform nenit 72 të LPP-së është dashur të kërkojë sqarime shtesë.

Përgjigje në pretendimin ankimor: Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar nuk ka cekur konkretisht se çfarë certifikata mungojnë për Metë Bytyqi dhe Përparim Selimaj, vetëm ka potencuar se u mungon certifikata. Mirëpo pas shqyrtimit të ofertës së OE ankues, në follderin me titull “STAFI 1”, nën follderin “7.hidroizolues” gjendet kontrata në emër të Metë Bytyqi, por mungon certifikata (diploma). Kurse, për Përparim Selimaj, në follderin me titull “8.STAFI 2”, nën follderin me titull “9.shtrues pollakash” gjendet kontrata e Përparim Selimaj, si dhe dy certifikata, njëra për siguri dhe shëndet në punë dhe certifikata tjetër kundër zjarrit, që të dyja nuk kanë të bëjnë me kërkesën e AK-së, por i mungon certifikata (diploma) për pllaka shtrues. Megjithatë, ekspertja shqyrtuese konsideron se AK gjatë vlerësimit të ofertave nuk i ka kushtuar rëndësi edhe emrave tjerë të cilët gjenden në follderin “pllaka shtrues” sepse janë edhe 3 persona tjerë të cilët e plotësojnë kërkesën e AK-së me certifikatat përkatëse. Sido që të jetë, AK ka mundur të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së me qëllim të marrjes së sqarimeve të nevojshme. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bërë në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së. Me qëllim të zbatimit të drejt të parimeve të LPP-së, konkretisht arritjes së economicitetit dhe efikasitetit, konsideroj se AK duhet të bëjë vlerësimin e ofertave në pajtim me kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së, kurse dilemat të cilat mund ti ketë për çmime jo normalisht të ulëta, atëherë të zbatoj udhëzimet e dhëna në nenin 41 të Rregullores.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë në bazë të konstatimeve të ekspertit shqyrtues

të cilave ky panel ju a fal besimin është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Renovimi I objekteve ne AKSP me numër të prokurimit: 214-25-4240-5-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ja fal besimin e plotë rekomandimit të ekspertit shqyrtues, pa nevoj që të njëjtat të përsëriten sërish ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Renovimi I objekteve ne AKSP me numër të prokurimit 214-25-4240-5-2-1, të anulohet njoftimi për dhenie te kontrates dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si të bazuara, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull “Renovimi I objekteve ne AKSP” me numër të prokurimit 214-25-4240-5-2-1 të kthehet ne rivlersim si dhe AK të veprojnë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - AKADEMIJA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**
- **OE - LevelMax L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: